

L I G J
Nr.7949, datë 14.6.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7597, DATË 31.8.1992 “PËR SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË SHTETIT”

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7597, datë 31.8.1992 “Për Shërbimin e Kontrollit të Shtetit” neni 4, pika 7 ndryshohet:

“Kontrollon veprimtarinë investuese shtetërore. Shqyrton ligjshmërinë dhe efektivitetin e prokurimit të fondeve me vlerë mbi 1 milion lekë në ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore përdoruese si dhe porositë shtetërore në subjektet private”.

Neni 2

Në nenin 5, pas pikës 10, të shtohen pikat 11 dhe 12 me përmbajtjen si vijon:

“11. Në rast shkeljesh të procedurave të prokurimit të fondeve, urdhëron përsëritjen e prokurimit nga organet përkatëse”.

“12. Gjobit:

a) deri në 6 paga mujore personat fajtorë që pengojnë kontrollin ose nuk paraqitin në afatet e caktuara nga Shërbimi i Kontrollit të Shtetit dokumente e të dhëna të kërkuara nga ky organ;

b) personat fajtorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, për fushën e veprimtarisë së Shërbimit të Kontrollit të Shtetit të parashikuara nga ky ligj.

Gjopa jepet nga inspektori i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit. Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve te kryetari i degës rajonale të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit ose drejtori i drejtorisë.”

Neni 3

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

- Pika 5 ndryshohet:

“Të pezullojë veprimet e kundërligjshme, objekt i kontrollit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, deri në shqyrtimin nga organi më i lartë nga varet subjekti i kontrolluar.

- Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“Për shkelje të ligjshmërisë në privatizimin e pronës shtetërore dhe në kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve, Shërbimi i Kontrollit të Shtetit ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë”.

Neni 4

Kryetarit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit me kërkesën e tij i jepet fjala për problemet ekonomiko-financiare në sesionet e Kuvendit Popullor dhe të komisioneve të tij. Ai dërgon përfaqësuesit e tij në mbledhjet e këshillave të rretheve, bashkive, komunave e në këshillat drejtuese të ndërmarrjeve shtetërore dhe në institucionet buxhetore, kur diskutohen aktet e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1139, datë 27.6.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha